

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Misin, Frangu dhe zyrtaren ligjore Albana Ajvazi, në çështjen juridike, të paditësit [REDACTED] nga Ferizaj rr." [REDACTED]" nr. [REDACTED], të cilin me autorizim e përfaqëson [REDACTED] avokate nga Ferizaj, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës Ministria e shëndetësisë Sherbimi Sherbimi Profesional i Shendetit Mendor-Shtime, të cilën e përfaqëson me autorizim [REDACTED] jurist i diplomuar nga Shtimja, në çështjen për pagesë e pagave përcjellëse dhe jubilare, në shqyrtimin e mbajtur me datë 06.11.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET, si e bazuar, kérkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj rr." [REDACTED]" nr. [REDACTED]

II.DETYROHET, e paditura Qeveria e Kosovës Ministria e Shëndetësisë Sherbimi Sherbimi Profesional i Shendetit Mendor -Shtime, që paditësit në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi prej 1471.56 €, dhe tri pagave jubilare në lartësi prej 1471.56 €, e që shuma e përgjithshme i bie **2,941.00 € (Dymijë e nëntëqind e dyzetë e një euro)**, të cilën shumë e paditura është obliguar t'ia paguaj paditësit, së bashku me kamatën, e cila do të llogaritet sipas lartësisë që llogarisin bankat për deponimet e rëndomta të qytetareve, të afatizuara për periudhë një vjeçare, pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive,

III.OBLIGOHET, paditësi të u a paguaj shpenzimet e kësaj procedurë për taksa gjyqësore shumen prej 40 €, per perpilim e padise shumen prej 104 €, si dhe për dy seancat e mbajtura shumen prej **270.00 €**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësi [REDACTED] përmes përfaqësuesit të tij avokate [REDACTED] me datë 21.07.2018 ka parashtruar padi kundër të paditurës Qeveria e Kosovës Ministria e Shendetësis Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor-Shtime, lidhur me pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe pagesën e tri pagave jubilare.

Pretendimet e palëve:

Paditësi përmes të autorizuarit të tij në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërsi si në padi dhe kërkesëpadi, me kërkes për tri paga përcjellëse në pension dhe tri pagave jubilare në kuptim te nenit 52.3 dhe neni 53 të marreveshjes së përgjithshme kolektive e cila marreveshje ka qenë në fuqi në kohen kur është pensionuar për shkakë të arritjes së moshes së pensionimit, në fjalen përfundimtare i ka propzuar gjykatës që kërkespadia e paditësi të aprovohet në tërsi si e bazuar dhe ta detyroj ë padituren që paditësit tia paguaj në emër të tri pagava përcjellëse për pension dhe tri pagat jubilare në shumen prej 2,941.00 €, i ka kërkuar shpenzimet e procedures për përfaqsim në dy seanca nga 135.00 €, për përpilimin e padisë shume prej 104.00 €, si dhe taksën gjyqësore në lartësi prej 41 €.

I autorizuari i të paditurës në seancat e mbajtura dhe në fjalëne përfundimtare ka mbetur në tërsi si në përgjigjëje në padi, paditësi padien e tij e ka mbështetur në një dokument që nuk ka qenë në fuqi sepse së dihet kontrata kolektive nuk ka gjetë zbatimin e saj, sepse pas nënshkrimit të kësaj kontrate nuk janë ndarë mjete buxhetore dhe në munges të këtyre mjeteve këto padi për këto mjete që IRSKP-ja, nuk mund të bëje përmbushjen të kësaj kërkesë të pageses. Praqsuesi i të paditures ka kundeshuar padie e paditësit, përfaqsues i të paditure i ka propozuar gjykates që të merr parasysh se në nuk jemi nënshkrues të kontratës kolektive dhe nuk kemi obligim që të bëhet pagesat i ka propozuar gjykatës që të refuzoj padie e paditësit si të pa bazuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së faktave të çështjes kontestimore, për aq sa palët ndërgjygjëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 8.1 të LPK-së, gjykata ka administruar provat si vijojnë: Kërkesa e ushtruar paditesi nga

[REDACTED] drejtuar Ministris Shendetesis në Prishtine, aktvendimi i datë 07.02.2017 me numer nga shërbimi Spitalor Klinika dhe Universiteti i Kosoves (Sherbimi Profesional i Shëndetit Mendor-Qendra Intergruese e Shëndetit Mendor Shtime), kontrata e punës me numer të protokollit 234 e datë 28.07.2013, gjendja e llogaris bankare –PCB e datë 06.07.2017

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mesë palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension, e paditura nuk e ka kontestuar pretendimet në padi nga ana e paditësit se ka përvojën e punës mbi 30 vjet.

Me leximin e Kontratës së punës me nr. Protokolli:234 e datës 28.02.2013, Gjykata ka konstatuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura deri në momentin e pensionimit me datë 17.02.2017, Me leximin vendimit e me nr. protokolli: 69 të datë 07.02.2017 , gjykata ka konstatuar se paditësi e ka ndërprer mardhënje e punës pas mbushjes se moshe 65 vjet, me leximin e llogaris bankore gjykata ka konstatuar se paditësi në tre muajt e fundit ka realizuar mesatare e pagës në shumë prej 490,52.00 €.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë për tri pagat jubilare në shumen prej 978.35 €, si dhe tri pagave përcjellëse shumen prej 978.35 €, e ka marrë për bazë kontratën e punës të lidhur në mes paditësit dhe të paditurës të datë 01.03.2015, si dhe shkresave të paditurës me nr. protokollit nr.387/7 të datë 13.06.2017, ku vërtetohet se paditësi në muajt fundit para daljës në pension dhe atë në nëntor, dhjetor dhe janar, është vërtetuar se paga mujore e tij ka qenë për tre muajet e fundit 490.52 €.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në nenin 53 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët ndërsa zbatohet prej 01 Janar të viti 2015 , ndërsa me nenin 51 të kësaj kontrate zbatohet në rastin ku ka implikime financiare.

Në pjesën hyrëse respektivisht ne nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontrate përfaktin se me rastin e daljes se tij në pension kontrata kolektive ka qenë në fuqi e cila nuk është kontestuar nga ana e të paditurës.

Në nenin 36 par. 9 pika 9.1 dhe 9.23, të kontratës kolektive përfaktë punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërbirim jubilar përf 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi, i fundit në vlerë të një page bazë, përf 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy pagave bazë dhe përf 30 vite të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej tri pagave bazë, punëdhënësi i fundit është ai që e paguan shpërbirimin jubilar, te shpërbimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension paditësit brenda 1 muaji sipas nenit 36 par. 9 pika 9.5 të ia paguajë tri paga jubilare pasi që i ka plotësuar këto kushte, pasi ka pasur përvojën e punës mbi 43 vjeçare dhe ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as përfaktë paraqitur ndonjë kërkesë çofitë gojore apo me shkrim të paditurës.

Kurse nenin 36 par. 10 të Kontratës kolektive përfaktë punësuarit në arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesat përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, e në rastin konkret Gjykata ka marr parasysh që tri pagat e fundit të punëmarrësit kanë qenë 490.52. € dhe nuk ka pas ndonjë ndryshim në tre muajt e fundit para daljes në pension dhe me rastin e vendosjes është bazuar në këtë fakt se meqenëse nuk ka pasur ndryshime në pagat që të merret një mesatare e ka marr përfaktë tri pagat e fundit që ka ndodh në rastin konkret rezulton se paditësi ka pasur pagën mujore tek e paditura shumën prej 490.52 €.

Pretendimet e përfaqësuesit të paditurës se paditësi kërkesën përfaktë kompensimin e pagave përcjellëse duhet të refuzohet përfaktin se e paditura nuk ka pasur fonde të veçanta që ti përmbrushë këto detyrime, këto pretendime përfaktë Gjykatën janë të pa bazuara përfaktin se me nenin 2 të kësaj kontrate Qeveria e Kosovës Ministria e shendetësis Sherbimi Sherbimi Profesional i Shendetit Mendor –Shtime , në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta

zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destuguara për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, ka obliguar të paditurën që t'ia kompensoj shumën prej 270.00 €, për përpilim të padisë shumën prej 104.00 €, për seancë të mbajtur shumën prej: 135.00 €, dhe taksën gjyqësore për padi në shumë prej 41.00 €.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.559/17 date 06.11.2018

Gjyqtari,

Misin Frangj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar arkesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVË

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNO-SNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më Dana 31. 01. 2019



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

VENDIMI ËSHTË I EKZEKTUESHËM
ODLUKA JE IZVRŠNA

Më dt. 04.02.2019 vit.
Dana god.

Punëtori i autorizuar
Ovlašteni radnik

